



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Punë të Jashtme
Mbledhja nr. 37
Prishtinë, më 26 tetor 2016, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

P r o c e s v e r b a l

i mbledhjes së Komisionit për Punë të Jashtme

Në mbledhje morën pjesë: Elmi Reçica, Blerta Deliu-Kodra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Ismet Beqiri, Pal Lekaj dhe Zafir Berisha.

Në këtë takim, morën pjesë edhe deputetët e Kuvendit: Ismajl Kurteshi, Aida Dërguti dhe Ganimete Musliu.

Munguan: Teuta Rugova, Qerim Bajrami e Puhie Demaku.

Në mbledhje ishin të pranishëm, ministrja për Dialog, Edita Tahiri, me stafin Ramize Sejdiu dhe Dren Zeka.

Nga zyra e Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Pjesëmarrës të tjerë: Eugen Cakolli, Jeta Krasniqi, Violeta Haxholli, Artan Murati, - KDI; Blerta Bejtullahu,- EU Office; Taulant Salihu, KREK; Alisa Hasani- PIPS; Vlora Nushi- UNMIK/OPA; Hajredin Skenderi -Swiss Embassy; Argjend Zejnaj -GP/AAK; Gurjeta Zeka, LVV; Qëndresa Misini -praktikante dhe media.

Mbledhjen e kryesoi: Elmi Reçica, kryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Raportim i ministres për Dialog, znj. Edita Tahiri.

Elmi Reçica e falënderoi ministren Tahiri për gatishmërinë që t'i përgjigjet ftesës për të raportuar në Komision. Në këtë takim tha se Komisioni ka paraparë që të diskutohet lidhur me

bisedimet Kosovë-Serbi, implementimin e marrëveshjeve dhe për çështje të tjera të cilat do të ngritën nga anëtarët e Komisionit. Z. Reçica tha se shpresojmë që në të ardhmen raportet dhe kontaktet do të shpeshohen, edhe nga fakti se në mes të Kuvendit dhe KDI, është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi, në kuadër të të cilit janë parashikuar aktivitete të ndryshme që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e punës së Qeverisë, njëkohësisht edhe mbikëqyrjes së dialogut Kosovë-Serbi. Ai falënderoi KDI- në, për materialin i cili u është shpërndarë deputetëve lidhur me angazhimet të cilat i ka pasur ministrja si bartëse e dialogut.

Edita Tahiri falënderoi Komisionin për ftesën për takim dhe mundësinë për të informuar lidhur me rrjedhat dhe rezultatet e dialogut të Brukselit. Theksoi se Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron se dialogu i Brukselit është një dialog për fqinjësi të mirë, për aspiratën tonë euroatlantike dhe përkushtimin për paqe dhe stabilitet në rajon dhe Evropë.

Dialogu i Brukselit ka dhënë rezultate mjaft të rëndësishme, tha ministrja Tahiri, dhe se për herë të parë janë arritur marrëveshje të nënshkruara mes dy shteteve të garantuara nga Bashkimi Evropian dhe të mbështetura nga SHBA- ja. Dialogu i Brukselit tha se ka kontribuar në forcimin e sovranitetit shtetëror, në shtrirjen e sovranitetit në veri të vendit, si dhe integrimin e serbëve të asaj pjese në sistemin shtetëror të Kosovës. Ajo theksoi se dialogu i Brukselit ka afruar Kosovën me Bashkimin Evropian dhe NATO-n, e është arritur nënshkrimi i MSA-së. Nga marrëveshjet e shumta që janë arritur, bëri të ditur se pjesa dërmuese e tyre zbatohen nga të dyja palët, por presin edhe shumë të tjera që të zbatohen.

Ministrja Tahiri bëri të ditura marrëveshjet e rëndësishme të arritura në mes të dy vendeve, si dhe njoftoi për vendosjen e sistemit unitar të drejtësisë edhe në katër komunat veriore të Kosovës. Në muajin nëntor tha se pritet hapja e zyrave në veri për pajisjen e qytetarëve me dokumente të shtetësisë dhe të gjendjes civile. Situata në veri të vendit tha se nuk ka qenë e mirë për një kohë të gjatë pas luftës, e cila ishte e trashëguar nga UNMIK-u, i cili nuk arriti të shtrijë administrimin në veri të vendit, dhe se për zgjidhjen e këtyre problemeve tha se ne kemi zgjedhur rrugën e dialogut, për ta ruajtur integritetin territorial të shtetit tonë.

Ministria Tahiri njoftoi se, gjatë muajve të ardhshëm do të nisë ndërtimi i objekteve të përhershme të IBM-it, që do të financohen nga Bashkimi Evropian, në pajtim me marrëveshjen e Brukselit për IBM. Ajo bëri të ditur se Serbia ka bllokuar marrëveshjen për Kodin telefonik dhe marrëveshjen për pavarësimin e KOSTT-it, për të cilat Bashkimi Evropian është duke u angazhuar për zhblokimin e tyre. Qeveria e Kosovës i ka bërë të qarta kushtëzimet, se pa e marrë Kodin telefonik nga ITU, që do të jetë 383, pa u pavarësuar KOSTT-i dhe pa shuarjen e plotë të strukturave të mbetura paralele, nuk do të ketë themelimin të Asociacionit të komunave me shumicë serbe. Ajo vuri në pah se Asociacioni nuk do të ketë kompetenca ekzekutive, nuk do të jetë një nivel i tretë i qeverisjes në Kosovës, dhe se kjo marrëveshje do të bazohet në ligjet e Kosovës. Sa i përket zbatimit të marrëveshjeve nga Serbia, tha se ajo do të detyrohet t'i zbatojë ato nga se përndryshe e bllokon rrugën e vet të integritetit evropian.

Ministrja Tahiri i njoftoi se në fazën e tretë të dialogut, që do të jetë fazë përmbyllëse, do të trajtohen çështja e të pagjeturve, reparacionet e luftës, demarkacioni i kufirit mes dy shteteve, sukcesioni, si dhe do të ndodhë njohja mes dy shteteve.

Ismet Beqiri përgëzoi ministren Tahiri për punën duke theksuar se procesi i dialogut është një proces i vështirë dhe kërkon sakrificë, qëndrueshmëri dhe përmbajtje në Kushtetutë dhe në ligjet tona. Te dialogu për marrëveshjet kërkohej të ketë edhe kompromise, por të mos jenë në dëm të vendit dhe në kundërshtim me Kushtetutën e vendit tonë. Dialogu tha se është instrument i vetëm për tejkalim të problemeve në mes të shteteve, dhe është i mbështetur nga BE- ja dhe SHBA- ja. Duke u ndërlidhur me Asociacionin e komunave tha se nuk mund të dilet jashtë asaj që e parashihet Gjykata Kushtetuese, ndërsa sa i përket procesit të dialogut, kërkoi që deputetët të jenë më të informuar.

Zafir Berisha duke u ndërlidhur me raportimin e ministres Tahiri tha se ne i kemi qëndrimet e tona lidhur me bisedimet dhe se historia do të tregojë se çfarë kategori e bisedimeve, kanë qenë këto bisedime në Bruksel. Pyeti ministren se a pritet të ndryshojë formati i bisedimeve i cili fillimisht ishte teknik, e më pas politik dhe tani me Serbinë trajtojmë gjëra të brendshme të Kosovës. Nuk pajtohet me ministren se bisedimet dhe marrëveshjet, janë bërë në harmoni me ligjet duke theksuar se ato janë të dëmshme dhe antikushtetuese, e një ndër ato tha se është marrëveshja e 10 shkurtit 2015. Siguria tha se nuk është ashtu siç prezantohet, në një raport të MPJ-së është thënë se politika ruse është evidente përmes disa OJQ-ve, që flet se pos Serbisë ka vende të cilat dëshirojnë që situatën ta mbajnë të acaruar. Po ashtu inkorporomi i strukturave paralele në institucione është gabimi më i madh që është bërë, dhe se kjo do të vërehet në një të ardhme të afërt. Zbatimi i ligjeve duhet të funksionojë në çdo cep të Kosovës dhe nuk duhet të ketë të privilegjuar në raport me ligjin në aspektin nacional, e as atë fetar.

Për marrëveshjen për asociacionin tha se është njëri ndër gabimet më të mëdha që është bërë. Ai pyeti ministren se sa ka dhënë rezultate Plani për miratimin e marrëveshjeve të Brukselit.

Pal Lekaj theksoi se Qeveria nuk ka qenë korrekte dhe nuk ka informuar drejt lidhur me bisedimet duke cekur se bisedimet janë të natyrës teknike për fqinjësi të mirë, për normalizimin e marrëdhënieve në mes të dy shteteve, por në fund po shihet se këto bisedime kanë qenë bisedime politike, të pa kornizuara me ndonjë preambulë, lidhur me njohjen reciproke në mes të dy vendeve. Nga këndvështrimi i tij tha se nga këto bisedime pa kornizë të saktë për interesa të shtetit të Kosovës, më tepër ka përfituar Serbia. Deri më tani tha se nuk është arritur integrimi i qytetarëve të Kosovës të komunitetit serb, nuk ka rezultate në sferën e energjisë, atë të telekomunikacionit e, po ashtu, edhe marrëveshja për targat është kundër identitetit të Republikës së Kosovës. Pyeti ministren se a janë shuar strukturat paralele, pasi që fillimisht ajo tha se janë shuar e më pas tha se pa u shuar ato, nuk do të fillojë hartimi i statutit të Asociacionit të komunave. Dështim të radhës tha se konsideron çështjen e të pagjeturve, gjë që do duhej të ishte prioritet në kornizën e bisedimeve edhe çështja e 1600 të pagjetur. Shprehu mendimin se sa i përket bashkimit të Mitrovicës jemi larg dhe se nuk mund të thuhet se kemi arritur rezultate historike.

Lidhur me vartësinë e kryeministrit Mustafa, z. Stojanoviq, pyeti se çka është ndërmarrë ndaj tij, i cili me paratë e taksapaguesve tanë, për rastin e Trepçës shkon në Beograd e Bruksel dhe se kujt i përgjigjet ai, qeverisë tonë apo Vuçiqit. Z. Lekaj tha se ky format i bisedimeve duhet të ndryshojë dhe ky dialog të ndërpritet, nga se është zbehur shumë shtetësia e Kosovës dhe shumë ministra lëshojnë takimet, për shkak se ende nuk është hequr fusnota për Kosovën.

Aida Dërguti tha se ministrja Tahiri, më 18 mars 2015, ka deklaruar se nuk do të hapet çështja e asociacionit pa u shuar strukturat paralele. Ndërkohë, diku pas dy muajsh, është nënshkruar marrëveshja dhe tani ministrja thotë se nuk do të ndodhë implementimi i saj, pa u shuar strukturat paralele. Pyeti ministren se pse duhet t'i besohet. Ajo po ashtu tha se ministrja lidhur me dialogun thotë se ka dhënë rezultate pozitive, ndërsa në gazetën Epokën e Re sot ka deklaruar se Serbisë nuk i intereson përmirësimi i marrëdhënieve shqiptaro-serbe, por projekti i Serbisë së madhe të cilin projekt mundohet ta rishfaqë në rrugë të tjera. Znj. Dërguti duke deklaruar se ministrja thotë sot dy deklarata të kundërta e pyeti atë për pozicionin e saj, se a mendon të tërhiqet nga dialogu apo se me këtë qasje mendon se duhet të vazhdojë dialogun më tej.

Blerta Deliu –Kodra tha se Qeveria e Presidenca, së fundi kanë deklaruar se pritet të fillohet një fazë e re e dialogut në mes të Kosovës e Serbisë, pyeti për formatin e këtij dialogu, temat të cilat do të trajtohen apo çfarë parashihet të arrihet me këtë format të dialogut. Ajo, po ashtu, pyeti se cilat do të jenë kushtet për të filluar kjo fazë e re e dialogut; se a ka pritshmëri që marrëveshjet e arritura të zbatohen plotësisht, para se të procedohet me një fazë të re të dialogut; për strukturat ilegale në veri; formimin e asociacionit të komunave serbe; zbatimin e marrëveshjes për kodin telefonik si dhe për qëndrimin e saj për temën e të pagjeturve.

Luljeta Veselaj -Gutaj kërkoi të informohet nga ministrja Tahiri se kur është trajtuar çështja e të pagjeturve për herë të fundit, sa është bërë për sensibilizimin dhe plotësimin e kushteve për kthimin e komunitetit shqiptar në pjesën veriore të Kosovës dhe se asociacioni i komunave serbe, a e prek Kushtetutën dhe sovranitetin e Kosovës.

Ismajl Kurteshi theksoi se është shumë e rëndësishme se si trajtohet Kosova në Bruksel, dhe pyeti ministren se a trajtohet si shtet i barabartë e sovran, apo si shtet të cilit lirinë ua sollën të tjerët dhe duhet të pranojnë atë që të tjerët ua ofrojnë.

Duke u ndërlidhur me raportimin e ministres, e pyeti atë se cilat janë rezultatet historike të cilat shkojnë në të mirë të Kosovës, sepse këto të cilat i ceku ajo më lart, tha se qytetarët e Kosovës nuk po i shohin. Pyeti ministren se bisedimet nga cilat ndarje e kanë shpëtuar Kosovën dhe shtoi se ka ndarje faktike ku e kanë të ndaluar të dalin edhe autoritet më të larta të shtetit. Strukturat paralele tha se nuk janë shuar, ato janë gjithkund edhe në Kuvendin e Kosovës, edhe në Ministri edhe në nivele lokale dhe paguhen nga buxheti i Kosovës. Lidhur me deklaratën e ministres se marrëveshjet e arritura zbatohen, z. Kurteshi tha se ato zbatohen nga ana e Kosovës dhe në interes të Serbisë. Pyeti ministren se a po zbatohen nga Serbia, marrëveshja për diplomat dhe për lëvizjen e lirë. Me marrëveshjen për policinë tha se ministrja me nënshkrimin e asaj marrëveshjeje ka bërë racizëm ku ka paraparë që për të qenë komandat policie në veri duhet të jetë nga komuniteti serb, e ngjashëm ka vepruar edhe për gjyqësi. Z. Kurteshi vlerësoi se në bisedime me Serbinë është biseduar për marrëdhëniet e brendshme të Kosovës, por jo për marrëdhëniet në mes të dy shteteve dhe se asnjëherë nuk është përmendur parimi i reciprociteti dhe çështja e shqiptarëve të Luginës së Preshevës. Ai, po ashtu, theksoi se ministrja gjatë negociatave dy herë e ka shndërruar Kosovën nga legaliteti në ilegalitet, një herë me rastin e fusnotës e herën tjetër me tabela të automjeteve që është përgjegjësi e madhe për të cilën duhet të përgjigjeni.

Z. Kurteshi i parashtroi edhe disa pyetje ministres si vijon: se a do të tërhiqet për dhënien e deklaratave ndryshe; cila është e vërteta rreth deklaratës se Kosova nuk posedon lista të të pagjeturve dhe kur do të trajtohet kjo temë; cilat janë temat që Qeveria sipas planit të saj për vitin

2014-2018, është zotuar se do t'i ketë në agjendën e procesit të normalizimit; cila është marrëveshja reale mbi targat; cila është marrëveshja e vërtetë mbi Kodin telefonik; kur do të bëhet regjistrimi i popullatës në pjesën veriore; në bazë të cilave ligje po bëhet ndërtimi i Luginës së diellit; se a e ka ngritur çështjen e dëbimit të shqiptarëve në vitin 2000-2001 nga shtëpitë e tyre në veri dhe a po angazhoheni që ata të kthehen në shtëpitë e tyre; kur do të ndodhë njohja e diplomave të Kosovës nga Serbia dhe pse nuk është ngritur në Bruksel çështja e kthimit të teksteve të dërguara nga Ministria e Kosovës në Luginën e Preshevës, përderisa Serbia po sjell në Kosovë tekste në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës.

Edita Tahiri i njoftoi anëtarët e Komisionit se për fazën e tretë të bisedimeve janë dorëzuar në Bruksel temat e bisedime e që janë: vendosja e kufirit ndërkombëtar mes dy shteteve, respektimi i fqinjësisë në mes të dy shteteve dhe mos ndërhyrja në sovranitetin e njëra- tjetrës, vendosja e bashkëpunimit ndërshtetëror në fushat me interes sipas standardeve evropiane e euroatlantike. Në kuadër të reparacioneve të luftës znj. Tahiri tha se kemi garancinë, për njohjen e shtetit sovran të Kosovës nga Serbia, për kushtëzimin e anëtarësimit të Serbisë në BE me njohjen e pavarësisë së Kosovës, për pamundësinë e Serbisë që ta pengojë anëtarësimin e Kosovës në BE dhe organizatat tjera ndërkombëtare duke përfshirë edhe OKB-në, për pamundësinë e Serbisë që të pengoj anëtarësimin dhe pjesëmarrjen e plotë të Kosovës në të gjitha organizatat ndërkombëtare të kulturës, sportit dhe për heqjen e Kosovës nga Kushtetuta e Serbisë. Për të parë rezultatet e marrëveshjeve të Brukselit në terren, tha se duhet pas parasysh si ka qenë gjendja para këtyre marrëveshjeve. Kufiri në mes të Kosovës e Serbisë në pjesën veriore ka qenë i hapur, kanë qenë porta të krimit dhe kontrabandës ku ka pasur struktura paralele të financuara nga Serbia. Kemi kthyer autoritetet shtetërore policinë dhe doganën në Jarinjë dhe Bërnjak dhe kemi vu kufirin. Dialogu hoqi nga rruga rrezikun që Serbia pretendonte vazhdimisht për ndarjen e Kosovës. Në dialogun e Brukselit tha se jemi shtet i pavarur dhe i barabartë e sovran, sepse GJND ka konfirmuar ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës. Shuarja e strukturave paralele në saje të dialogut ka ndodhur në disa fusha. Në polici, integrimi i ish -policëve në policinë e Kosovës, sipas modeleve që kanë ndodhur në shtetet e tjera, si p.sh. në Kroaci. Janë shuar strukturat paramilitare të mbrojtjes civile dhe janë hequr pikat vëzhguese nga ura deri te kufiri në veri. Kemi shuar strukturat në dogana me heqjen e vulave paralele dhe zyrave paralele të doganave. Reciprociteti është arritur edhe në lëvizjen e lirë, njohjen e dokumenteve të shtetësisë, tregti të lirë dhe në mbulimin e tabelave. Znj. Tahiri theksoi se fusnota e zbuti qëndrimin e pesë vendeve mos njohëse të pavarësisë së Kosovës për të votuar MSA. Njoftoi se themelimi i asociacionit është kushtëzuar me shuarjen e plotë të strukturave të mbetura paralele dhe ftoi anëtarët e Komisionit të jenë pjesë e grupit punues ditën e fillimit të hartimit të statutit të asociacionit. Serbia tha se është duke e bllokuar Kodin telefonik të Kosovës, por BE është duke punuar në këtë drejtim që të zbatohet marrëveshja për kodin telefonik dhe KOST-in.

Pal Lekaj theksoi se derisa ministria thotë se Asociacioni nuk është në kundërshtim me Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese me 24 nene ka konstatuar se ai është në frymën jo Kushtetuese. Duke u ndërlidhur me mundësinë e formimit të asociacioneve në bazë të ligjit, pyeti ministren se pse është dashur të bëhet marrëveshja për Asociacionin e komunave në Bruksel dhe se a është injoruar ligji ynë me këtë rast. Z. Lekaj theksoi se me rastin e ri integritit të policisë në Kroaci, është bërë pastrimi i figurave të policëve.

Edita Tahiri njoftoi se me rastin e ri integritit të policëve, ata kanë kaluar në procesin e pastrimit institucional të shtetit tonë. Marrëveshja për Asociacionin tha se nuk e ka shkelur Kushtetutën dhe se vendimi i gjykatës Kushtetuese për Asociacionin duhet të respektohet dhe ta mbyll këtë çështje.

Ismajl Kurteshi tha se bisedimet kanë filluar gabimisht tha se flet fakti se ato kanë filluar me një shtet që nuk e njeh Kosovën, se është pranuar të shkohet në bisedime si palë e paqartë dhe keni hequr dorë nga elementi i reciprocitetit. Në bisedimet në Bruksel ministrja vazhdimisht ka biseduar për çështje të brendshme të Kosovës dhe asnjëherë nuk ka biseduar për marrëdhënie bilaterale. Asociacioni është çështje e brendshme e Kosovës dhe nuk ka guxuar të jetë temë e bisedimeve me Serbinë. Serbet janë duke i kundërshtuar, si në Kuvend edhe në Qeveri, çështjet më të rëndësishme për vendin, siç është formimi i ushtrisë së Kosovës dhe çështje të tjera të rëndësishme që janë argumente të forta se po punojnë për Serbinë dhe janë larg integritit ashtu siç kanë qenë në vitin 2000-2002.

Edita Tahiri bëri të ditur se në Bruksel është biseduar për fqinjësi të mirë që nënkupton që Serbia t'i ndal ndërhyrjet dhe t'i shuaj strukturat paralele. Sa i përket reciprocitetit tha se, është arritur reciprocitet për lëvizjen e lirë, për tregti të lirë, dhe për IBM. Në bashkëpunimet rajonale para vitit 2011 Kosova nuk ka mund të merrte pjesë, por atëkohë përfaqësohej nga UNMIK-u, ndërsa tani Kosova në mekanizma ndërkombëtarë e rajonal përfaqësohet vetë. Çështja e shqiptarëve të Luginës së Preshevës, nuk u shtrua në Bruksel, nga se koncepti i dialogut ishte në mes të dy shteteve, dhe nuk ishte i karakterit etnik. Theksoi se njohja e diplomave ka dështuar, Serbia këtë e ka bërë me qëllim për ta cenuar perspektivën e shqiptarëve të Luginës, ndërsa ne kemi dështuar ta zbatojmë marrëveshjen për kadastra. Duke u ndërlidhur me pyetjen e deputetes Blerta Deliu –Kodra tha se, pa u zbatuar marrëveshjet e pazbatuara nuk do të fillojë faza e tretë e bisedimeve, e cila do të jetë më e shkurtër se fazat e tjera. Lidhur me pyetjen e deputetes Luljeta Veselaj- Gutaj, ministrja bëri të ditur se çështja e të pagjeturve ishte diskutuar në një fazë të bisedimeve, por ka mbetur të trajtohet në fazën e tretë të bisedimeve. Për çështjen e të pagjeturve tha se jemi të interesuar të gjithë, por politika e Serbisë është ajo e cila nuk i ka hapur arkivat ushtarake.

Elmi Reçica falënderoi ministren Tahiri për raportimin duke bërë të ditur se Komisioni ka marrë obligime që të jemi më shpesh bashkë në takime dhe të kërkojmë raportime nga ministrja dhe ekipi i saj. Ai po ashtu shprehu gatishmërinë e Komisionit, që të mbështesë këtë proces.

Në fund të takimit, Komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më datë 4, 5 dhe 7 tetor 2016.

Mbledhja përfundoi në orën 15:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Elmi Reçica